

Njoftim për kërkim kandidaturash për ndjekje kualifikimesh

1	Titulli i kursit	Aspektet ligjore të luftës kundër korrupsionit / <i>Legal Aspects of Combating Corruption (LACC)</i>
2	Kriteret e kërkuara të gradës	Kapiten – Kolonel/civil ekuivalent
3	Kriteret e kërkuara të gjuhës	Anglisht minimalisht 80 pikë ALCPT/ECL
4	Përshkrimi	Ky kurs promovon njohjen dhe bashkëpunimin e institucioneve partnere në luftën kundër korrupsionit. Kursi synon dhënien e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të studentëve për të ngritur shqetësimin përreth fenomenit të korrupsionit, si edhe eksplorimin e mekanizmave të reja frytdhënëse në luftën ndaj tij. Përgjatë programit të kursit pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të fitojnë njohuri dhe aftësi të mira në perceptimin, zbulimin dhe ndjekjen e aferave korruptive e gjithashtu të vihen në kontakt të drejtpërdrejtë me praktikantët dhe bazat ligjore ndërkombëtare përsa i përket luftimit të këtij fenomeni. Kursi do të bëjë të mundur prezantimin e studentëve me mekanizmat ndërkombëtarë ligjorë për luftën ndaj korrupsionit si fenomen, ndërthurjen e ligjeve dhe institucioneve të ndryshme në procesin e luftimit të korrupsionit.
5	Periudha e zhvillimit të kursit	17.11.2021 deri më 17.12.2021
6	Vendi i zhvillimit të kursit	Newport, Rhode Island, SHBA
7	Afati aplikimit elektronik (sipas lidhjes 4)	21.04.2021
8	Kuota	2 (dy) kuota